



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT  
Sektori i Asistencës dhe Shërbimit

Nr. 777/ Prot.

Tiranë, më 18.01.2017

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Z.Artan Rama

TIRANË

I nderuar z.Rama,

Në cilësinë e kërkuarit, keni depozituar në rrugë elektronike, kërkesën për dhënie informacioni, regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 17 datë 12.01.2017, bazuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit, në të cilën kërkoni listën emërore të punonjësve të regjistruar si të punësuar në subjektin Qendra “U R A”, nipt L21721454C, për periudhën Janar 2016 – Janar 2017.

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, në nenin 24 dhe 25, përcakton në mënyrë të qartë autoritetet dhe rrethanat, të cilave Administratat Tatimore mund dhe duhet t’iu ofrojë, pas kërkesës me shkrim, informacion tatimor për tatimpaguesit, të administruar prej saj dhe konkretisht citojmë: *“Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:*

- a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;
- b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;
- c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;

- c) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;
- d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;
- dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;
- e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.”

Për sa më sipër, duke mos qenë subjekt i nenit 24, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk mund t’ju ofrojmë informacion në lidhje me kërkesën e paraqitur nga ju.

Sipas kërkesës tuaj, kjo përgjigje do t’ju dërgohet në mënyrë elektronike në adresën tuaj të e-mailit: [artanrama@gmail.com](mailto:artanrama@gmail.com).

Ju falenderojmë për mirëkuptimin,

**ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**XHAVIT ÇURRI**

